Përplasja e mësueseve të shkollës “Çajupi”/ Zbardhen emrat e personave të përfshirë në sherr, kush qëlloi me armë

12/10/2021 ne **Aktualitet, Kronike**

Përplasja e mësueseve të shkollës “Çajupi”/ Zbardhen emrat e personave të përfshirë në sherr, kush qëlloi me armë

Janë zbardhur emrat e përfshirë në sherrin masiv që ndodhi para shkollës “Andon Zakon Çajupi” në kryeqytet, pak para nisjes së mësimit. Mësohet se të përfshirë në ngjarje janë shtetasit Edmond Faja, Elton Kasaj, Enrik Qenami, Enea Kovaçi, Ndriçim Qefalia, Laert Duro, Alvaro Toptani, Domenik Toptani dhe Elida Qenami (mësuesja).

Për të rejat më të fundit behuni pjesë e grupit tonë VIRAL në facebook : PAMFLETI

Siç është mësuar nga hetimet, Edmond Faja, Elton Kasaj, Ndriçim Qefalia dhe Laert Duro kanë qenë pjesë e një grupi.

Nga ekzaminimet e policisë dyshohet se në ajër ka qëlluar Edmond Faja, i cili është arrestuar nga policia, ndërsa të tjerët janë proceduar në gjendje të lirë.
Ndërsa Alvaro Toptani fill pas momentit të konfliktit është larguar dhe policia po punon për kapjen e tij për të sqaruar rrethanat.

Policia ka sekuestruar armën e përdorur nga Edmond Faja, një pistoletë TT dhe nga kontrolli i territorit në vendin e ngjarjes, pranë rrethimit të shkollës është gjetur një tjetër armë zjarri që dyshohet se i përket Ndriçim Qefalisë, punonjës i Policisë Ushtarake.

- Lexo edhe:

Një nga rusët ish-gjeneral ushtrie; zbardhen detaje, pistat ku po hetohet për vdekjen e 4 turistëve

Green Pass për auditoret, por jo kafenet; vaksinimi “i detyruar” me dy standarte, Bino ia lë përgjegjësinë ‘në derë’ Komitetit

Nga konflikti Enea Kovaçi mori dëmtime serioze dhe është duke marrë mjekim në Spitalin e Traumës.

Njoftimi:

Dokumentohet ngjarja e ndodhur mëngjesin e ditës së djeshme, në rrugën “Kongresi i Manastirit”.

Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen penalisht 6 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër shtetas.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë.

Në vijim të punës për dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur mëngjesin e ditës së djeshme, në rrugën “Kongresi i Manastirit”, në përfundim të veprimeve hetimore, specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Nr. 4 bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit E. F., 39 vjeç dhe proceduan penalisht shtetasit E. K., 30 vjeç, E. Q., 41 vjeç, E. K., 32 vjeç., N. Q., 43 vjeç, L. D., 41 vjeç, si dhe shpallën në kërkim shtetasin A. T., 27 vjeç.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se në një lokal në afërsi të një shkolle në rrugën “Kongresi i Manastirit”, fillimisht janë konfliktuar verbalisht, për motive të dobëta (për vend qëndrimi në lokal) shtetasja E. Q., 46 vjeçe dhe D. T., 53 vjeçe. Më pas janë përfshirë në konflikt duke përdorur sende të forta, të afërmit përkatës të tyre, konkretisht shtetasit E. F., E. Q., 41 vjeç, N. Q., 43 vjeç dhe L. D., 41 vjeç (të afërmit e shtetases E. Q.) dhe shtetasit E. K., 32 vjeç, E. K., 30 vjeç dhe A. T., 27 vjeç (të afërmit e shtetases D. T). Si pasojë e konfliktit është dëmtuar me sende të forta shtetasi E. K., 32 vjeç, i cili ndodhet në spital, jashtë rrezikut për jetën.

Gjithashtu, gjatë konfliktit dyshohet se shtetasi E. F. (i arrestuar) ka qëlluar në ajër me një armë zjarri pistoletë, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.

19 Oct 2021, 1:40 AM (GMT)

Coronavirus Statistikat

178,188	2,829	169,085
Raste	Vdekje	Te sheruar

Te rekomanduaraLajme

Një nga rusët ish-gjeneral ushtrie; zbardhen detaje, pistat ku po hetohet për vdekjen e 4 turistëve
OCTOBER 18, 2021

Green Pass për auditoret, por jo kafenet; vaksinimi “i detyruar” me dy standarte, Bino ia lë përgjegjësinë ‘në derë’ Komitetit
OCTOBER 18, 2021

Dyfishohet numri i të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në burgje
OCTOBER 18, 2021

Misteri i vdekjes së 4 turistëve rusë/ Anila Hoxha: Nuk u gjet asgjë kompromentuese!
OCTOBER 18, 2021

Vaksinimi me detyrim, Rama zbut tonet; çfarë do ndodhë me studentët
OCTOBER 18, 2021

Vdekja e mistershme e 4 turistëve rusë në Kavajë, flet kolegia e një prej viktimave: Po shkruhen gjëra pa kuptim
OCTOBER 18, 2021

Lajmi i Dites

Presioni i SHBA/ Vitore Tusha fut në axhendë shkarkimin e Presidentit. A po e tradhëton Marsida Xhaferllari binomin Berisha- Meta?
OCTOBER 18, 2021

Lajmet e fundit

Një nga rusët ish-gjeneral ushtrie; zbardhen detaje, pistat ku po hetohet për vdekjen e 4 turistëve
OCTOBER 18, 2021

Vetingu për politikanët, Rama tregon kushtet: Nëse opozita na bind, jemi të hapur për dialog!
OCTOBER 18, 2021

Green Pass për auditoret, por jo kafenet; vaksinimi “i detyruar” me dy standarte, Bino ia lë përgjegjësinë ‘në derë’ Komitetit
OCTOBER 18, 2021

Dyfishohet numri i të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në burgje
OCTOBER 18, 2021

Parajsa e minjve, eksperimenti që zbulon në themel natyrën njerëzore dhe shpjegon problemet e sotme
OCTOBER 18, 2021

Me Bashën në tavolinë? Rama e thotë prerë: Nuk flas më anglisht me opozitën!
OCTOBER 18, 2021

Misteri i vdekjes së 4 turistëve rusë/ Anila Hoxha: Nuk u gjet asgjë kompromentuese!
OCTOBER 18, 2021

Rritja e çmimit të energjisë për bizneset e mëdha, Rama: E vendos enti! Nuk kam asnjë koment
OCTOBER 18, 2021

Pse jeni në humor të keq dhe si ta trajtoni atë
OCTOBER 18, 2021

Gola dhe spektakël në “Loro Boriçi”/ Vllaznia “zhyt 6 pashë” Dinamon, shkodranët nuk zhgënjejnë dhe fundosin ‘nëndetësen blu’ (Video)
OCTOBER 18, 2021